



STRATEGJIA E ORGANIZATËS PËR ZHVILLIMIN E ADMINISTRATËS TATIMORE

2015 – 2019

Mjedisi ekonomik dinamik, përmbushja e pritshmërisë së tatimpaguesve dhe mbështetja Shqipërisë Europiane në proceset integruese, janë sfidat kryesore ne vitet e ardhshme. Administrata Tatimore është e përkushtuar t'i përmbushë të gjithë objektivat, duke promovuar vlerat më të mira të saj.

Qëllimi i Planit tonë Strategjik

Qëllimi i këtij plani strategjik është krijimi i një udhëzuesi të nivelit të lartë për punën për zhvillim gjatë periudhës 2015-2019, që do të siguronte që administrata jonë tatimore të harmonizohej më mirë me praktikën e mira ndërkombëtare, përfshirë edhe Udhëzuesit Fiskal të Bashkimit Europian (BE), nga sa është e harmonizuar sot. Kjo ka të bëjë me kuadrin e përgjithshëm të administrimit tatimor (për shembull, legjislacioni procedural, strukturat organizative dhe të drejtimit të brendshëm dhe sistemet e menaxhimit të ecurisë), funksionet qendrore të punës (për shembull, regjistrimi i tatimpaguesve dhe sistemet e deklarimit dhe pagimit), menaxhimin e përmbushjes së detyrimeve tatimore nga subjektet (për shembull, mbledhja dhe shpërndarja e të dhënave dhe informatave, hartimi i strategjisë së përmbushjes, shërbimet e tatimpaguesve, kontrolli tatimor, hetimi tatimor dhe sistemi për ankesat e tatimpaguesve) dhe teknologjinë informatike (për shembull, shfrytëzimi i duhur, administrimi dhe mirëmbajtja e sistemit të ri të marrë së fundmi).

Misioni

Mbledhja e të ardhurave tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, duke zbatuar njëtrajtësisht legjislacionin tatimor, për financimin e buxhetit të shtetit shqiptar.

Vizioni

Arritja e një stadi ku të jemi administratë tatimore europiane në mbështetje të qytetarëve për rritjen e mirëqenies së tyre, duke luajtur plotësisht rolin tonë në proceset integruese europiane.

Vlerat

Të jemi partnerë profesionistë për tatimpaguesit duke shërbyer me integritet, përkushtim, profesionalizëm, bashkëpunim, transparencë dhe etikë.

Gjatë tetëmbëdhjetë muajve të fundit kemi bërë ndryshime ekstensive dhe progres në Administratën Tatimore.

Kemi arritur të hartojmë dhe vëmë në punë një platformë të re informatike, brenda një periudhe jashtëzakonisht të shkurtër. Shumë aktorë, këtë sukses tonin në kuadër të kësaj nisme, e kanë quajtur të jashtëzakonshëm.

Kemi hartuar me sukses një model të riskut tatimor të mbështetur në rregulla, për të përmirësuar orientimin e punës për rritjen e përmbushjes së detyrimeve tatimore, përfshirë edhe punën për shërbimet kundrejt tatimpaguesve dhe kontrollin tatimor.

Kemi hartuar strategji të organizatës për reformën dhe për menaxhimin e përmbushjes tatimore dhe kemi ngritur komitete drejtuese për të siguruar kontrollin e duhur mbikëqyrës dhe orientimin e kësaj pune.

Kemi kaluar në deklarinë elektronik për të gjitha deklaratat tatimore dhe i kemi përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore në Administratën Tatimore

E kemi përmirësuar regjistrimin e tatimpaguesve dhe kemi një funksion relativisht të fortë të shërbimeve të tatimpaguesve.

Këto suksese të reformave bëjnë që të jemi në gjendje t'u bëjmë ballë vështirësive në kuadër të arritjes së qëllimeve dhe objektivave tanë, të vendosur në këtë strategji, dhe t'ua bëjmë më tërheqëse donatorëve dhe ofruesve të asistencës teknike investimin më tej për të ardhmen tonë.

Nevojat kryesore për zhvillim

Megjithëse kemi arritur shumë progres gjatë dy viteve të fundit, sidomos përmes vënies në zbatim të një sistemi të ri të teknologjisë informatike, ende mbetet shumë për të bërë, për ta ngushtuar hendekun midis praktikave tona të tanishme tatimore dhe praktikave të administratave tatimore më të mira. Puna jonë do të përqendrohet tek i. modernizimi i mëtejshëm i kodit të procedurave tatimore, ii. rritja e kapacitetit tonë për planifikim strategjik dhe matje të rezultateve të punës, dhe organizimi i administratës sonë në bazë të funksioneve qendrore të administratës tatimore, iii. përshtatja e strukturave në qendër dhe në drejtori rajonale në përputhje me nevojat tona të punës, iv. realizimi i programeve të gjithanshme të menaxhimit të përmbushjes për të zbutur risqet kryesore që i kanosen përmbushjes së detyrimeve nga tatimpaguesit në bazë të modeleve të segmentimit të tatimpaguesve, v. krijimi i kapacitetit për hetimin e mashtrimeve me tatim-taksat, vi. ngritja e standardit të proceseve të punës për funksionet qendrore të administrimit tatimor, vii. shfrytëzimi dhe mirëmbajtja siç duhet i sistemit të ri informatik, për t'i përmbushur më mirë nevojat operative dhe të raportimit tek niveli drejtues dhe viii. Futja në zbatim e politikave për drejtimin e burimeve njerëzore që krijojnë stimuj për rezultate të larta në punë dhe korrupsion të pakë.

Kështu do të arrijmë sa më poshtë

- Rritje të nivelit të mbledhjes së të ardhurave nga Administrata Tatimore
- Rritje të përqindjes së deklarimit në kohë
- Rritje të përqindjes së pagimit në kohë
- Ulje të kostos për të deklaruar dhe paguar
- Ulje të kostove të përmbushjes (ushtrimit të veprimtarisë tregtare)
- Rritje të numrit të tatimpaguesve të kënaqur.

QËLLIMI I – PËRMIRËSIMI I KUADRIT TË PËRGJITHSHËM TË ADMINISTRIMIT TATIMOR

Objektivat	Çështjet kyçe
<p>KUADRI LIGJOR</p> <p>Do të realizojmë një kuadër ligjor ku të parashikohen: 1. autonomi e mjaftueshme politike, 2. lirshmëri për të organizuar strukturat tona dhe për ta rekrutuar dhe caktuar personelin në përputhje me nevojat tona, 3. kompetenca të fuqishme për administrimin tatimor, 4. delegim i mjaftueshëm dhe i qartë i autoritetit tek nëpunësit e DPT-së, 5. një regjim sanksionesh të forta por të logjikshme dhe 6. të drejta dhe detyrime adekuate të tatimpaguesve.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtojmë kuadrin ekzistues të legjislacionit tatimor (në bashkëpunim me Ministrinë e Financave), pra aktet ligjore dhe nënligjore, kodet, etj., për të identifikuar pengesat ndaj arritjes së objektivit. 2. Hartojmë propozime të gjithanshme legislative në përgjigje të problemeve të identifikuara gjatë shqyrtimit. 3. Analizojmë legjislacionin dhe çdo kërkesë tjetër të jashtme që përcakton lirshmërinë dhe aftësinë e DPT-së: 1. për t'i administruar siç duhet burimet e veta njerëzore dhe 2. për ta përshtatur strukturën e vet organizative sipas nevojës, me qëllim identifikimin e rezultatit përfundimtar ideal dhe vlerësimin e kufizimeve ndaj arritjes së këtij rezultati përfundimtar. 4. Hartojmë propozime për ndryshimin që nevojitet. 5. Shqyrtojmë dispozitat ligjore për delegimin e autoritetit për të ushtruar kompetencat administrative dhe zbatuese dhe për të parë sa adekuate janë. 6. Kërkojmë kryerjen e ndryshimeve të nevojshme për të vendosur delegimet formale bazuar në role.
<p>PLANIFIKIMI STRATEGJIK DHE OPERATIV</p> <p>Do të realizojmë strategji të gjithanshme dhe plane veprimi të organizatës për operacionet e përditshme si edhe për zhvillimet institucionale.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zbatojmë këtë strategji të organizatës përmes hartimit të planeve operative vjetore dhe nënstrategjive (për shembull, strategjive për përmbushjen, teknologjinë informatike, burimet njerëzore) në mbështetje të çdo qëllimi dhe objektivit strategjik. 2. Bëjmë mbikëqyrje qendrore të zbatimit të planeve strategjike dhe operative.

Plani Strategjik 2015-2019

<p>STRUKTURAT DREJTUESE</p> <p>Do të realizojmë një strukturë të duhur të drejtimit të brendshëm për të administruar punën e përditshme dhe detyrat për zhvillim.</p>	<p>Përforcojmë funksionimin e efektshëm të komiteteve drejtuese ekzistuese, pra të reformës, operacioneve, përmbushjes, dhe do të sigurojmë që vendimet e komiteteve drejtuese të shoqërohen me veprim nga nivelet drejtuese.</p>
<p>ORGANIZIMI DHE ORGANIKA</p> <p>Do të strukturohemi, organizohemi dhe pajisemi me personel për të identifikuar dhe menaxhuar të gjithë risqet dhe prioritetet e rëndësishme.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Finalizojmë strukturën e re organizative të DPT-së në bazë të funksioneve, dhe do të hartojmë një plan zbatimi dhe mekanizëm monitorimi për lëvizjen e funksioneve, punës dhe personelit. 2. Hartojmë metoda për të siguruar marrëdhënie të efektshme funksionale midis skemës së programit dhe operacioneve. 3. Analizojmë fuqinë punëtore sa i takon numrit dhe aftësive, do të identifikojmë boshllëqet në krahasim me situatën aktuale dhe do të shpërndajmë burimet në përputhje të nevojave të punës. 4. Shqyrtojmë strukturën rajonale dhe të zyrave në terren dhe do të zbatojmë ndryshimet e nevojshme për të qenë në përputhje me nevojat e punës. Në këtë aspekt, do të marrim në konsideratë lirshmërinë që ofron sistemi i ri informatik sa i takon shpërndarjes së detyrave dhe do të shikojmë mundësitë e përqendrimit të disa prej detyrave në një numër më të vogël zyrash.
<p>MENAXHIMI I REZULTATEVE TË PUNËS</p> <p>Operacionet tona do të menaxhohen dhe vlerësohen në bazë të një sistemi të menaxhimit të rezultateve të punës.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillojmë një sistem të menaxhimit të rezultateve të punës dhe do të monitorojmë treguesit kyç të performancës për funksionet me rëndësi kryesore të punës, domethënë për regjistrimin, shërbimet, deklarin, pagimin, rimbursimin e TVSH-së, kontrollin tatimor, menaxhimin e borxhit, hetimin tatimor dhe apelimin. 2. Ngremë një sistem të menaxhimit të performancës për drejtuesit dhe personelin.

QËLLIMI II – Fuqizimi i procedurave kryesore të punës

Objektivat	Çështjet kyçe
<p>REGJISTRIMI I TATIMPAGUESVE</p> <p>Do të realizojmë sisteme të plota dhe të sakta për regjistrimin e tatimpaguesve.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sigurohemi që drejtorja e regjistrimit të tatimpaguesve brenda departamentit të hartimit të programeve të përqendrohet tek vijimi i operacioneve të ruajtjes së cilësisë dhe pastrimit të regjistrit. 2. Punojmë me Ministrinë e Ekonomisë për të ripërcaktuar mënyrën e shkëmbimit të informacionit mes QKR-së dhe DPT-së (për komunikimin dypalësh dhe përditësimet) 3. Hartojmë dhe zbatojmë një aktmarrëveshje me standarde shërbimi me QKR-në, ku të përfshihet saktësia e të dhënave, periudhat e rifreskimit, etj. 4. Parashikojmë një kërkesë nga personeli i DPT-së dhe QKR-së për të gjithë klientët për të konfirmuar informacione të përzgjedhura të regjistrimit. 5. Sigurohemi që ekzistojnë procese të rregullta dhe të plota për zbulimin dhe evidentimin e subjekteve pasive/joekzistente. 6. Sigurohemi që regjistrimet me rrezikshmëri të lartë (p.sh. me TVSH) të menaxhohen siç duhet duke përdorur metoda të përshtatshme sipas riskut.

Plani Strategjik 2015-2019

Objektivat	Çështjet kyçe
<p>DEKLARIMI DHE PAGIMI I DETYRIMEVE TATIMORE</p> <p>Do të realizojmë sisteme të thjeshta dhe deklarata tatimore të qarta dhe të thjeshta përmes të cilave tatimpaguesit të depozitojnë deklaratat tatimore dhe të paguajnë detyrimet tatimore.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Monitorojmë gabimet e zakonshme që bëjnë tatimpaguesit në deklarim dhe do të përgatisim zgjidhje ose përmes edukimit të tatimpaguesve ose përmes përmirësimit të formularëve. 2. Sigurohemi që perceptimet që kanë tatimpaguesit për deklarimin dhe pagimin të testohen përmes vrojtimeve të kryera nga Shërbimet e Tatimpaguesve. 3. Hetojmë alternativat e pagimit elektronike që përdorin kanalet më të mundshme (p.sh. zyrat e postes dhe bankat)
<p>RIMBURSIMI TATIMOR</p> <p>Do të krijojmë procedura të efektshme të rimbursimit, të bazuara në risk.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ngremë dhe pajisim me personel drejtorinë e rimbursimit brenda strukturës së hartimit të programeve. 2. Përcaktojmë se ku dhe si do të verifikohet rimbursimi në strukturën operative (telefonata, kontroll nga zyra, kontroll në subjekt, etj.). 3. Hartojmë, përmirësojmë dhe zbatojmë modelin e riskut të rimbursimit dhe kreditimit të TVSH-së 4. Hartojmë dhe zbatojmë procese dhe procedura që duhen ndjekur për të gjitha situatat e kreditit

Qëllimi III – Zbatimi i një qasjeje moderne për përmbushjen tatimore

Plani Strategjik 2015-2019

Objektivat	Çështjet kyçe
<p>SHËRBIMET E TATIMPAGUESVE</p> <p>Një funksion i shërbimeve të tatimpaguesve që harton dhe realizon orientime për tatimpaguesit të lehta dhe të thjeshta për t'u kuptuar mbështetur në nevojat e tatimpaguesve dhe në risqet e përmbushjes duke përdorur një larmi kanalesh komunikimi.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sigurohemi që drejtoria e shërbimit dhe regjistrimit të tatimpaguesve brenda departamentit të hartimit të programeve të funksionojë dhe të jetë pajisur siç duhet. 2. Hartojmë dhe fillojmë zbatimin e një strategjie për shërbimet e tatimpaguesve. 3. Hartojmë një strategji për kanalet e komunikimit (që ndërthur faqen në internet, telefonin, SMS-të, postën dhe vizitat në subjekt) për të siguruar mbështetje të efektshme për tatimpaguesit që do të kontribuojnë në realizimin e strategjisë për përmbushjen tatimore. 4. Realizojmë pyetësor të rregullt me tatimpaguesit për të vlerësuar ato që pret komuniteti dhe sa të kënaqur janë tatimpaguesit me shërbimet që u bëhen. 5. Krijojmë një kulturë të shërbimeve për tatimpaguesit, brenda administratës tatimore.
<p>KONSULTIMET ME TATIMPAGUESIT</p> <p>Do të ngremë sisteme dhe procedura për t'u konsultuar me tatimpaguesit dhe këshilltarët e tyre për një varg çështjesh të lidhura me përmbushjen tatimore.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ngremë dhe mbështetim komitetet këshillimore për të mbuluar një sërë grupesh, p.sh. ekspertët fiskalë, grupet kryesore të lobimit. 2. Publikojmë rregullisht vërejtjet dhe sugjerimet e marra nga këto komitete. 3. Krijojmë një mjet përmes të cilit publiku i gjerë të mund të bëjë sugjerime për përmirësimin e punës së DPT-së.

Plani Strategjik 2015-2019

Objektivat	Çështjet kyçe
<p>MENAXHIMI I RISKUT TË PËRMBUSHJES TATIMORE</p> <p>Do të ngremë struktura dhe sisteme të fuqishme për mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave dhe informatave për mashtrimin tatimor si edhe për tendencat dhe risqet e lidhura me përmbushjen e detyrimeve tatimore dhe për hartimin dhe zbatimin e strategjive me synim zbutjen grupeve madhore të risqeve të identifikuara, kryesisht në bazë segmentesh të tatimpaguesve.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sigurohemi që drejtoria e menaxhimit të riskut brenda departamentit të hartimit të programeve të funksionojë dhe të jetë pajisur siç duhet. 2. Realizojmë versionin e parë funksional të modelit të riskut dhe do ta zhvillojmë më tej atë me kalimin e kohës. 3. Zhvillojmë Bazën e të Dhënave dhe sigurojmë arkitekturën e informacionit për të organizuar siç duhet ruajtjen e të dhënave. 4. Planifikojmë dhe zbatojmë një strategji për përmbushjen tatimore (të harmonizuar me Modelin e BE-së për përmbushjen tatimore), me disa faza, duke filluar me projekte pilot në tri fusha risku të përcaktuara mirë
<p>PËRMBUSHJA E DETYRIMIT PËR DEKLARIM</p> <p>Do të kemi sisteme të efektshme përndjekjen e përmbushjes së detyrimit për bërjen e deklaratave tatimore.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përdorim plotësisht funksionin rikujtueses të automatizuar në sistemin e ri informatik për të ulur nivelin e mospërmbushjes 2. Monitorojmë efektivitetin e qasjes së re. 3. Shqyrtojmë kërkesat lidhur me shpeshtësinë e deklarimit dhe kompleksitetin e deklaratave tatimore (sipas segmenteve të tatimpaguesve) për të ulur barrën e përmbushjes për tatimpaguesit. 4. Rishikojmë vendimet në lidhje me vetëvlerësimin e mosdeklaruesve në mënyrë që të ekuilibrohet efekti që ka vetëvlerësimi tek ecuria me rritjen e stokut të borxhit.

Plani Strategjik 2015-2019

Objektivat	Çështjet kyçe
<p>PËRMBUSHJA E DETYRIMIT TË PAGESËS</p> <p>Do të realizojmë sisteme të plota dhe të efektshme për të monitoruar përmbushjen e detyrimit të tatimpaguesve për të paguar dhe për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura tatimore.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtojmë proceset dhe kompetencat e mbledhjes me forcë të detyrimeve për të përmirësuar efektivitetin dhe për të bërë ndryshimet e nevojshme. 2. Shqyrtojmë strukturën organizative të mbledhjes së borxhit pranë DP-së dhe DR-ve dhe do të mendojmë cilat janë mundësitë për t'i përqendruar detyrat në një numër më të vogël DR-sh. 3. Rrisim numrin e punonjësve të administratës tatimore të cilëve u ngarkohet detyra e mbledhjes me masa shtrënguese sipas udhëzimeve ndërkombëtare (10-15%). 4. Shfrytëzojmë plotësisht kapacitetin e DPT-së për ndjekje të automatizuar të detyrimeve të pagesës. 5. Sigurojmë një përgjigje me prioritet për borxhin e ri. 6. Shqyrtojmë politikat ekzistuese për shuarjen e borxhit dhe do t'i shfrytëzojmë këto politika për të eliminuar borxhin e pambledhshëm. 7. Shqyrtojmë a janë adekuate masat për të siguruar pagesën paraprakisht të tatimit mbi fitimin dhe do të bëjmë rekomandime për përmirësim (p.sh., akte ligjore dhe nënligjore).
<p>MENAXHIMI I PËRMBUSHJES SË TATIMPAGUESVE TË MËDHENJ</p> <p>Do ta fuqizojmë punën për menaxhimin e përmbushjes së subjekteve të mëdha.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vendosim kritere për përfshirjen e tatimpaguesve në DTM dhe do t'i zbatojmë rreptësisht çdo vit. 2. Bëjmë specializim sipas sektorit ekonomik (p.sh., sektor financiar, telekomunikacion, energjetikë, ndërtim, prodhim, produkte farmaceutike, arsim, tregti, shërbime) dhe do të vazhdojmë me mobilizimin e ekipeve me disa persona 3. Formojmë inspektorët e kontrollit tatimor në menytë që ta rrisin cilësinë e kontrollit, duke filluar që gjatë vitit 2015. 4. Ngremë një mekanizëm të kontrollit të cilësisë së kontrolleve tatimore (p.sh., shqyrtim kolegjal, sektori i kontrollit të cilësisë, pyetësorë për tatimpaguesit). 5. Shikojmë mundësinë e futjes së mjeteve elektronike të kontrollit tatimor dhe marrim një vendim.

Plani Strategjik 2015-2019

Objektivat	Çështjet kyçe
<p>KONTROLLI I TATIMPAGUESVE</p> <p>Do ta fuqizojmë më tej drejtorinë e kontrollit tatimor për të siguruar që puna e kontrollit të tatimor të përbëjë një frenues për mospërbushjen.</p>	<p>Rindërtojmë qasjen e përgjithshme për kontrollin tatimor në kuadër të kalimit drejt qasjeve të mbështetura në risk që mbështetin qasje bashkëkohore, të efektshme dhe të paanshme për kontrollin tatimor. Këtu, për shembull, përshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Procedura dhe manuale të rishikuara. • Trajnim i specializuar për inspektorët e kontrollit tatimor për pjesëmarrësit në projekte pilot, duke provuar metoda të reja. • Plane të trajtimit të kontrollit për risqe të veçanta. • Qasje e posaçme për rastet me risk të lartë. • Përzgjedhje, trajnim dhe monitorim personeli për të siguruar që qasja e re do të japë rezultate.
<p>INDIVIDËT ME PASURI TË MADHE</p> <p>Do të ngremë struktura dhe sisteme për të menaxhuar përmbushjen e individëve me pasuri të madhe sa i takon tatimit mbi të ardhurat personale.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësojmë gatishmërinë e mjedisit për të filluar një program për individët me pasuri të madhe (IPM). 2. Kur të jetë gati mjedisi, do të mbështetim me burime dhe hartojmë një program bashkëkohor evropian për IPM-të në mënyrë të rregullt duke përdorur një personel të trajnuar me kujdes.

Plani Strategjik 2015-2019

Objektivat	Çështjet kyçe
<p>HETIMI TATIMOR</p> <p>Do të fuqizojmë strukturat dhe punën për të hetuar rastet madhore të mashtrimit tatimor.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillojmë struktura dhe sisteme për ta fuqizuar funksionin e mbledhjes së informatave dhe do ta përqendrojmë mandatin e informatave të mbledhura për hetimin e mashtrimit tatimor. 2. Rindërtojmë procesin e hetimeve për t'u marrë vetëm me hetimet dhe informatat e çështjeve penale dhe për t'i çliruar burimet e Task Forcës për prioritetet e tjera të administratës. 3. Shqyrtojmë sistemet dhe proceset për të mbrojtur sigurinë e informacioneve të mbledhura dhe të transmetuara dhe do të shqyrtojmë sigurinë lidhur me mjediset e hetimit. Do të zbatohen ndryshimet e nevojshme. 4. Shqyrtojmë dispozitat e marrëdhënieve të punës për personelin e hetimit tatimor në lidhje me sigurinë e punës. 5. Qartësojmë rregullat në bazë të të cilave inspektorët e kontrollit tatimor duhet të njohin dhe kallëzojnë rastet e kontrollit tek hetimi tatimor kur mund të ketë përshkallëzim në hetim penal. <p>Vijojmë punën në bashkëpunim me ministritë përkatëse për të siguruar që hetuesit tatimorë të vazhdojnë të jenë të përfshirë në procesin e ndjekjes penale gjersa të jenë siguruar të gjitha provat përkatëse (në përfundim të hetimit) dhe që ata të marrin pjesë siç duhet në proceset gjyqësore.</p>
<p>BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË TJERA</p> <p>Do ta fuqizojmë më tej bashkëpunimin/lidhjet me agjenci dhe institucione të tjera (p.sh., policinë, prokurorinë, gjyqësorin) për të ndihmuar në punën për përmbushjen.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillojmë marrëdhënie funksionale me partnerë kyç (në veçanti, me doganat) sidomos lidhur me menaxhimin e përbashkët të strategjive dhe operacioneve për përmbushjen e tatimpaguesve/subjekteve. 2. Plotësojmë protokolle për të garantuar shkëmbimin pa probleme të informacioneve midis institucioneve shtetërore dhe do të vendosim lidhje për të marrë të dhëna në kohë reale, sipas nevojës.

Plani Strategjik 2015-2019

Objektivat	Çështjet kyçe
<p>APELI TATIMOR</p> <p>Do ta fuqizojmë më tej punën për të siguruar që tatimpaguesve që nuk janë dakord me një vendim që merr administrata tatimore t'u vihen në dispozicion procedura apeli dhe ankimi të drejta, transparente dhe të ekuilibruara.</p>	<ol style="list-style-type: none"> Shqyrtojmë bazën ligjore që krijon funksionin e apelit, me qëllim: <ul style="list-style-type: none"> Emërimin e kreut të apelit në të njëjtën mënyrë si edhe çdo post që jep llogari drejtpërdrejt tek Drejtori i Përgjithshëm. Sigurimin e pavarësisë së procesit të apelit nga vendimmarrja që apelohe. Largimin e avokatit të tatimeve nga struktura e DPT-së për ta nxjerrë në pah pavarësinë e këtij roli. Hartojmë një model bashkëkohor pune për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në DPT, përfshirë edhe eliminimin e kërkesës për të paguar principalin dhe gjobat si kusht për bërjen e një apeli. Zbatojmë këtë model të ri. Qartësojmë rolin e avokatit të tatimeve dhe ta bëjmë të qartë që ky pozicion të mos japë llogari përpara titullarit të administratës tatimore dhe që roli i avokatit të tatimeve të përfshijë shqyrtimin si procedural ashtu edhe në themel. Sigurohemi që funksioni i apelit të përdoret si funksion i kontrollit të cilësisë për DPT-në përmes shpërndarjes së brendshme të konstatimeve.

Qëllimi IV – Përdorimi i teknologjisë informatike në mënyrën më të mirë

Objektivat	Çështjet kyçe
------------	---------------

Plani Strategjik 2015-2019

<p>ZBATIMI I SISTEMIT TË TEKNOLOGJISË INFORMATIKE</p> <p>Do të përfundojmë vënien në zbatim të sistemit të ri informatik.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bëjmë një marrëveshje në nivel shërbimi për funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit informatik. 2. Përfundojmë vënien në zbatim të sistemit të përpunimit përmes përmblotjes së detyrave që kanë mbetur ende pa u bërë në planin e zbatimit. 3. Bëjmë marrëveshje informacioni me të tretë dhe protokolle komunikimi. 4. Angazhohemi me konsulencën për magazinën e të dhënave për të ndërtuar dhe mobilizuar një funksion të magazinës së të dhënave. 5. Caktojmë “titullarë procesi pune” për çdo aspekt të funksionalitetit të sistemit. 6. Krijojmë një “sektor të zgjidhjeve të proceseve të punës” që do të interpretojë dhe hartojë zgjidhje për problemet e proceseve të punës. 7. Fusim procese që sigurojnë që arkitekti i zgjidhjeve të menaxhojë ndërveprimin midis titullarëve të proceseve të punës dhe Drejtorisë së IT-së për të siguruar rezultate të efektshme.
<p>PËRDORIMI I SISTEMIT TË TEKNOLOGJISË INFORMATIKE</p> <p>Do të kuptojmë si ta përdorim teknologjinë informatike për të mundësuar arritjen e qëllimeve të punës.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vendosim me çfarë burimesh do të mbështetet teknologjia informatike: brenda organizatës, me kontraktim tek të tretë apo ndërthurje e të dyjave. 2. Vendosim cilat funksione informatike duhen mbajtur brenda organizatës, pavarësisht strategjisë që vendoset lidhur me mbështetjen me burime. 3. Përshkruajmë rolet/funksionet e ardhshme që siguron TI përmes një Plani strategjik 4-vjeçar për TI-në, duke përfshirë edhe kërkesat paraprake për shpenzimeve kapitale. 4. Hetojmë statusin si specialist të punonjësve të TI-së dhe do të rishikojmë në bazë të kësaj vendimet e parashikuara në pikën 21.1.